UDHËZIM
Nr.2211, datë 25.11.2010

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK", TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.31, datë 20.1.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.31, datë 20.1.2001, është 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj.
2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.31, datë 20.1.2001 është 9 500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë në muaj.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektin nga data 1.12.2010.

MINISTRI I PUNËS ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera